

UDHËTIMI nëpër INTERNET



GJURË DHE LETËRSI
TEMA:
DHUNA DIGJITALE

UDHËTIMI NËPËR INTERNET

UDHËTIMI nëpër INTERNET

Udhëzues për prindër



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology

Prishtinë, 2017

UDHËTIMI NËPËR INTERNET

Udhëtimi nëpër internet

Autore: **Teuta Zymeri**

Redaktore: **Merita Januzi dhe Mimoza Hasani Pllana**

Lektore: **Afërdita Kryeziu**

Kontribuesit:

Alush Istogu

Faton Fetahu

Avni Rexha

Veton Alihajdari

Habibe Buzuku

Shkëndije Nagafci

Edi Puka

Shpresa Shala

Bislim Krasniqi

Minire Gashi

Liridon Latifi

Anil Gashi

Fotografia: **Norik Uka**

Dizajni: **Leopard Cana**

Botues: **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT)**

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MAShT dhe autoreve

<https://www.masht.rks-gov.net>

Përmbajtja

Parathënie	6
Hyrje	7
Fëmijët dhe interneti	9
Çka nuk dinë shumica e prindërve për qasjen në internet	11
Aktivitetet online dhe pasojat	13
Rreziqet potenciale nga përdorimi i internetit	14
Shenjat paralajmëruese kur një fëmijë mund të jetë në rrezik nga përdorimi i internetit	16
Roli i prindërve	18
Si t`u ofroni fëmijëve tuaj përdorim të sigurt të internetit	20
Konkluzione	30

UDHËTIMI NËPËR INTERNET

PARATHËNIE

Udhëzuesi për Prindër ofron këshilla për prindër rreth sigurisë së fëmijëve në internet. Ky botim është përgatitur nën përgjegjësinë e MASHT-it, në suazat e iniciativës nga stafi i të drejtave të njeriut/ fëmijës për krijimin e një platforme të qëndrueshme për mbrojtjen e fëmijëve në internet. Krahas përpjekjeve të MASHT-it për avancimin e përdorimit të teknologjisë informative në përditshmërinë e shkollave tona, synojmë edhe ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor për përdorim efektiv dhe të përgjegjshëm të internetit, duke shmangur keqpërdorimet dhe rreziqet e mundshme që vijnë nga interneti.

Ky udhëzues i dedikuar prindërve do t`u shërbejë atyre që të jenë mbrenda sitemit të mbrojtjes së fëmijëve, duke zbatuar këshillat dhe rekomandimet relevante për rolin e tyre në këtë fushë.

Përgatitja e këtij udhëzuesi është realizuar me konsultime të vazhdueshme me ekspertë të brendshëm dhe të jashtëm të kësaj lëmie.

(Autorja/redaktoret)

HYRJE

Tanimë jemi në epokën digjitale dhe përdorimi i internetit është në nivel të lartë nga të gjitha grupmoshat. Sot interneti është pothuajse burimi kryesor i informacionit për të gjitha fushat dhe i pranishëm në çdo situatë, si në shkollë, ashtu edhe në punë dhe në familje. Komunikimi nëpërmjet internetit tashmë tejkalon çdo formë tjetër komunikimi. Por, si në familje, ashtu edhe në shkollë e gjetiu, kërkohet përdorim racional dhe i përgjegjshëm i internetit, për të mos rënë pre e rreziqeve dhe e keqpërdorimeve të mundshme, duke qenë të vetëdijshëm se jo gjithmonë interneti përdoret nga njerëz korrektë e të sjellshëm.



Qëllimi i udhëzuesit për prindër është që të kemi partneritet të fortë me komunitetin e prindërve dhe në bashkëpunim me mësimdhënësit të arrijmë ta ndërtojmë një kulturë të shëndoshë të fëmijët tanë për përdorimin e internetit në mënyrë të dobishme, duke qenë të mbrojtur nga rreziqet online. Kështu, të fëmijët duhet ta kultivojmë komunikimin e mirë dhe ndjenjën e kontrollit mbi veprimet e tyre online, duke promovuar sjelljet e shëndosha dhe korrekte të komunikimit/ përdorimit të internetit në çfarëdo relacioni.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

Familja, shkolla dhe shoqëria kanë përgjegjësi në edukimin e fëmijëve, në mënyrë që atyre mos t'iu cënohet zhvillimi fizik dhe intelektual. Sa i përket internetit, ata duhet ta shfrytëzojnë atë për mësim, komunikim, lojë e argëtim, por, gjithashtu, duhet t'i njohin edhe rregullat e komunikimit dhe t'i respektojnë kufijtë dhe rregullat mbi kohën e qëndrimit të tyre në internet, ngase përdorimi i tepruar dhe shmangia nga aktivitetet fizike, i dëmton ata në aspektin shëndetësor. Ndërkaq, përdorimi i tepërt dhe pa qëllimin arsimor i dëmton ata edhe në aspektin intelektual, në kuptimin e rënies së rezultateve dhe ngecjeve drejt arritjeve në mësim.

Gjithashtu, gjatë përdorimit të pakontrolluar të internetit, fëmijët nuk e ruajnë privatësinë e tyre e të familjes, duke komunikuar me të panjohur, gjë që shpie deri te ekspozimi ndaj rreziqeve tjera, si: dhuna, trafikimi, grabitja, ekspozimi ndaj përmbajtjeve pornografike dhe abuzimeve tjera online.

Është përgjegjësi e jona e përbashkët që të kujdesemi për fëmijët dhe t'i mësojmë ata për sigurinë në internet. Kjo rrugë mund të jetë e vështirë, meqë teknologjia avancon çdo ditë dhe jo të gjithë prindërit mund të kenë njohuri dhe të ecin në hap me zhvillimet teknologjike. Prandaj, ky udhëzues ka për qëllim që t'ua lehtësojë punën juve si prindër apo edhe kujdestarë ligjorë, në edukimin e fëmijëve rreth mbrojtjes në internet. Si i tillë, ky udhëzues ka dy objektiva:

- të informojë prindërit se për çfarë e përdorin internetin fëmijët e tyre dhe cilat janë rreziqet potenciale gjatë përdorimit të tij;
- të këshillojë prindërit dhe edukatorët se çfarë mund të bëjnë ata për t'i mbrojtur fëmijët nga rreziqet e ndryshme dhe si t'i ndihmojnë ata të përballen me rreziqe të tilla.

Ne rekomandojmë që Udhëzuesi për prindërtë përdoret nga prindërit dhe të rriturit tjerë që përkujdesen për fëmijë dhe t'i zbatojnë udhëzimet bazike të paraqitura këtu për mbrojtjen e fëmijëve të tyre në internet.

FËMIJËT DHE INTERNETI

Zhvillimet teknologjike u mundësojnë fëmijëve që të kenë qasje 24 orë në internet. Këto zhvillime mund të jenë shumë pozitive për jetën e fëmijëve, por në anën tjetër mund të sjellin edhe rreziqe të ndryshme për ta. Gjithsesi, mënyrat e mënjanimit të rreziqeve varen shumë nga vendi dhe pajisja prej nga fëmijët kanë qasje në internet.

Vendet prej nga fëmijët kanë qasje në internet janë:

Shtëpia - shumica e familjeve tani në shtëpitë e tyre kanë kompjuter personal, laptop apo ndonjë pajisje që kanë qasje në internet.

Shkolla - shumica e shkollave posedojnë kabinete të kompjuterëve prej nga fëmijët mund të qasen në internet. Poashtu, shumica e shkollave kanë wi-fi dhe kjo u mundëson fëmijëve kyçje në internet nga pajisjet e tyre personale.

Miqtë apo të afërmit - edhe nëse fëmijët tuaj nuk kanë qasje në internet nga shtëpia, ekziston mundësia që ata të përdorin kompjuterin e miqve apo të afërmeve të tyre për t'u qasur në internet.



UDHËTIMI nëpër INTERNET

Internet Cafe - janë ambiente publike për qasje dhe përdorim të internetit, ku duhet paguar për kohën sa shfrytëzohet interneti.

Zona publike - fëmijët mund të kenë qasje të lirë në wireless të ofruar nga kafiteri, apo nga zona të tjera publike.

Përpos vendit të qasjes në internet, dallon edhe mënyra apo pajisja që fëmijët përdorin për t'u lidhur me internet. Disa prej pajisjeve më të shpeshta që fëmijët i përdorin për t'u kyçur në internet janë:

Kompjuteri (PC) - shumë shtëpi dhe shkolla tani posedojnë kompjuter, prej nga është e mundur qasja në internet.

Laptopi ose tabletët e ndryshëm - çdo ditë e më shumë fëmijët po përdorin laptop apo tabletë të ndryshëm për t'u lidhur në internet.

Telefonat e mençur - përmes telefonave të mençur fëmijët mund të kyçen në internet. Gjithashtu, gati të gjithë operatorët që ofrojnë shërbime të telefonisë mobile, tani ofrojnë edhe shërbimet e internetit nëpërmjet telefonit mobil.

Pajisjet për lojëra (Nintendo Wii, PlayStation, Xbox 360) - shpeshherë prindërit apo edukatorët e fëmijëve mund të mos jenë të vetëdijshëm që qasja në internet është e mundur edhe përmes pajisjeve për lojëra.



PËR ÇFARË E PËRDORIN FËMIJËT INTERNETIN?



Interneti fëmijëve u ofron mundësi shumë të mira për të mësuar gjëra të reja që lidhen me interesat e tyre të përgjithshme, me hobia apo detyrat shkollore. Gjithashtu, interneti mund të përdoret për argëtim, si: për të dëgjuar muzikë, për të luajtur lojëra, për të shikuar filma, apo për të komunikuar me të tjerët. Sidoqoftë, grupmosha të ndryshme e përdorin internetin në mënyra të ndryshme dhe për arsye të ndryshme. Mëposhtë kemi paraqitur aktivitetet kryesore në internet sipas grupmoshave, duke marrë parasysh grupmoshat sipas niveleve arsimore (sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit - KSNA).

Mosha 5 - 6 vjeçare (klasa përgatitore)

Parashkollorët/ parafillorët janë mjaft të rritur për të filluar eksplorimin në internet dhe për të mësuar në lidhje me botën digjitale. Fëmijët që nga mosha pesëvjeçare fillojnë të vizitojnë faqet e internetit për fëmijë, por duhet pasur parasysh që ata gjithmonë duhet të jenë të shoqëruar nga prindërit. Preferohet që fëmijët e kësaj moshe të kalojnë sa më shumë kohë me moshatarët e tyre dhe larg nga ekranet digjitale.

Gjithsesi, shumë prindër mund të gjejnë përmbajtje interesante që mund të zgjojnë kureshtjen e fëmijëve të tyre. Video të ndryshme në Youtube (për këtë moshë preferohet të përdoret Youtube Kids) mund t'u shërbejnë prindërve për t'iu mësuar fëmijëve të tyre këngë të ndryshme apo për t'i argëtuar ata. Prindërit duhet të kenë kujdes që fëmijët në këtë moshë të mos e asociojnë argëtimin vetëm me përdorim të telefonit apo kompjuterit, por të zhvillojnë lojëra interaktive, në mënyrë që fëmija të zhvillohet sa më shëndetshëm.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

Mosha 6-10 vjeçare (klasat 1-5)

Kjo grupmoshë është më problematike për t'u menaxhuar, për shkak që fëmijët janë mjaft të vetëdijshëm për përdorimin e internetit dhe për mundësitë që ofron ai, por ata nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet online. Gjithashtu, fëmijët e kësaj grupmoshe e kanë më të vështirë t'i kuptojnë rreziqet, edhe nëse prindërit apo edukatorët ju shpjegojnë lidhur me to.

Disa fëmijë të kësaj moshe mund të fillojnë të përdorin pavarësinë e tyre për të kërkuar në internet materiale të papërshtatshme për moshën e tyre. Reklammat e ndryshme në internet mund të synojnë këtë moshë, por kjo moshë, gjithnjë e më shumë, mësojnë të njohin dallimin në mes reklamimit dhe materialeve të tjera. Kjo ndihmon për të folur me fëmijët rreth reklamave, rrjeteve sociale, etj. dhe mënyrave se si duhet të përdoren ato. Aftësitë dhe pavarësia e tyre do të vazhdojnë të rriten. Por, nëse hulumtimin në internet e zhvillojmë si një aktivitet të përbashkët familjar, kjo u mundëson prindërve që t'i mbikëqyrin nga afër fëmijët e tyre.

Mosha 11-14 vjeçare (klasat 6-9)

Në moshën e adoleshencës interneti bëhet një mjet i rëndësishëm në jetën e tyre. Tanimë ata fillojnë të përdorin internetin për hulumtime lidhur me detyrat e shtëpisë dhe për projekte të ndryshme. Njëkohësisht, adoleshentët e rinj fillojnë të bëhen më të pavarur, fillojnë të kenë më shumë vetëbesim, si dhe gjithnjë e më shumë duan liri. Shumica e fëmijëve në këtë moshë e kanë krijuar profilin e tyre në internet dhe janë të kyçur në rrjete sociale, kështu edhe shkëmbimi i emailave rritet.

Disa mund të kundërshtojnë përdorimin e programeve për filtrim dhe bëjnë përpjekje për të hyrë në faqe të internetit që kanë material të papërshtatshëm. Shumë adoleshentë më të rritur mund të fillojnë të krijojnë programet e tyre dhe tanimë dinë si të menaxhojnë pajisjet digjitale shumë më mirë sesa vetë prindërit apo edukatorët. Këto shkathtësi dhe njohuri të tyre mund t'iu sjellin telashe, nëse ata nuk janë të informuar për rreziqet që mund të shfaqen në internet. Fëmijët në këtë moshë kanë më shumë tendencë që të kundërshtojnë prezencën e të rriturit gjatë përdorimit të internetit. Prandaj, rekomandohet që informimi për rreziqet online të bëhet pjesë e diskutimeve të shpeshta në familje apo klasë. Kjo është një mënyrë e mirë që stimulon vetë fëmijët që pastaj ta diskutojnë këtë temë edhe me shoqërinë e tyre.

AKTIVITETET ONLINE DHE PASOJAT E MUNDSHME

Aktiviteti	Pasojat e mundshme
Krijimi i profileve personale	Duke krijuar dhe plotësuar profilet personale në internet, shpeshherë fëmijët pa dashje iu lejojnë personave të tjerë të keqpërdorin të dhënat e tyre personale, si: emrin, adresën, numrin e telefonit, emrin e shkollës dhe në këtë mënyrë mund edhe të zbulojnë vendbanimin aktual, gjë që mund të shpie deri te shqetësimete ndryshme psikike dhe fizike.
Postimet në rrjete sociale (fotografi, video, lokacione etj.)	Postimet në rrjete sociale, sidomos nga fëmijët, shpeshherë mund të jenë me pasoja. Arsyeja pse ky veprim mund të jetë i tillë, është për shkak se automatikisht mundësohet shikimi i fotografive/videove apo edhe i lokacionit nga persona të panjohur, të cilët edhe mund të shfrytëzojnë rastin që të manipulojnë me këto përmbajtje. Ky fakt posaqërisht vlen në rastet kur parametrat e privatësisë nuk janë të rregulluar siç duhet. Kemi raste të shumtasi në Kosovë, ashtu edhe në nivel global kur fëmijëve iu ka keqpërdorë fotografia, duke vendosur fytyrën e fëmijës në një trup tjetër. Kjo fotografi pastaj është shpërndarë në internet për të dëmtuar reputacionin etij. Poashtu, postimi i thashethemeve, shpërndarja e sekreteve të të tjerëve në internet janë shumë të shpeshta në rrjetet sociale.
Dërgimi dhe përgjigjja në mesazhe kërcënuese dhe ngacmuese	Rrjetet sociale përdoren masivisht për bashkëbisedim, qoftë me persona të njohur apo edhe të panjohur. Si pasojë e përdorimit të këtyre platformave për bashkëbisedim, fëmijët shpeshherë bëhen viktimë apo edhe viktimizues të moshatarëve të tyre, duke dërguar mesazhe kërcënuese dhe ngacmuese. Rekomandohet që fëmijët t'i ruajnë këto mesazhe dhe të njoftojnë prindërit për këto mesazhe shqetësuese. Sidoqoftë, fëmijët asnjëherë nuk duhet të përgjigjen në mesazhe të tilla.
Bisedat online me të panjohurit	Ndër rreziqet kryesore të përdorimit të internetit nga ana e fëmijëve është bashkëbisedimi me persona të panjohur. Është faktike se fëmijët gjatë bisedës me këta persona ndajnë informacione personale. Duke marrë parasysh se këta persona mund të shfrytëzojnë këto të dhëna personale për të ushtruar sajbërdhunë apo frikë mbi fëmijët, ky fenomen është mjaft shqetësues. Sidoqoftë, shqetësimi më i madh qëndron tek rreziku eventual kur fëmijët mund të takojnë dikë online, me të cilin pastaj mund të takohen ballëpërballë dhe si pasojë mund të vie deri te pasojat e ndryshme, si: ngacmimi, dhunimi, rrëmbimi, apo edhe trafikimi.
Shkarkimi i përmbajtjeve nga burime të panjohura	Shkarkimi i një video apo fotografie mund të bartë viruse të fshehura. Këto viruse mund të dëmtojnë kompjuterin, ose mund t'ukrijojnë mundësi dërguesvetë këtyre viruseve që të kenë qasje në të dhënat tuaja personale. Rekomandohet që fëmijët të shkarkojnë përmbajtje vetëm nga burime të sigurta, të cilat zakonisht janë të vlerësuara me notë (nota është në formë ylli, sa më shumë yje aq më i sigurt është burimi).
Lojërat online	Avansimi i lojërave online krijon mundësi që lojtarët të mund të bisedojnë me njëri-tjetrit, apo edhe të kenë pamje të njëri-tjetrit në kohë reale. E gjithë kjo ndodh me qëllim që loja të jetë sa më atraktive. Sidoqoftë, kjo e rrit edhe mundësinë e ekspozimit ndaj rreziqeve të cilat janë përmendur më lart, e që vijnë nga përdorimi i internetit.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

RREZIQET POTENCIALE NGA PËRDORIMI I INTERNETIT

Ritmi i shpejtë i zhvillimit të teknologjisë dhe mënyra me të cilën të rinjtë janë aftësuar për përdorimin e kësaj teknologjie vazhdojnë të sfidojnë sigurinë e fëmijëve në internet. Rreziqet nga përdorimi i internetit rriten krahas përmirësimit të shkathtësive të fëmijëve për përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informative. Në këtë mënyrë ata krijojnë një lloj pavarësie e cila nxit kureshtjen dhe gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për qasje në faqe të internetit, të cilat kanë përmbajtje të papërshtatshme për moshën e tyre. Në përgjithësi, rreziqet nga të cilat kanosen fëmijët gjatë përdorimit të internetit mund të jenë si vijon:



- Përdorimi i tepruar i internetit në dëm të aktiviteteve sociale dhe fizike në natyrë, të cilat janë shumë të rëndësishme për shëndetin dhe zhvillimin social të fëmijës.
- Rreziku për dëmtime fizike, ngacmim, abuzim fizik, psikik dhe seksual nga personat me të cilët fëmijët aranzhojnë dhe realizojnë takime të drejtpërdrejta.
- Ekspozimi ndaj përmbajtjeve të paligjshme dhe të dëmshme, si: pornografia , lojërate ndryshme dhe kontaktet me persona të panjohur.

- Krijimi dhe shpërndarja e përmbajtjevetë paligjshme dhe të dëmshme nga vetë fëmijët.
- Ekspozimi ndaj fjalimeve, teksteve dhe imazheve raciste dhe diskriminuese.
- Pretendimi për të qenë dikush tjetër me qëllim mashtrimi, dëmtimi, ngacmimi apo detyrimi.
- Zbulimi i informatave personale mund të çojë deri te rreziku i dëmtimit fizik dhe psikik.
- Kontaktete padëshirueshme, veçanërisht me mashtrues, me të rritur, që paraqiten si fëmijë.
- Rreziku nga vetëdëmtimi që vjen si pasojë e sjelljeve të dhunshme dhe destruktive të fëmijës tuaj.
- Marrja dhe postimi i fotove të papërshtatshme, pa marrë paraprakisht lejen, të cilat mund të jenë të dëmshme për të tjerët. Shkelja e të drejtave të autorit, p.sh. shkarkimi i muzikës, i imazheve dhe i programeve për të cilat duhet paguar për t'i poseduar.
- Përdorimi i paautorizuar i kredit kartelave të prindërve apo të të tjerëve për pagesa në faqe të ndryshme të internetit.
- Përdorimi i llogarisë së prindërve pa pëlqimin e tyre (kur kërkohet pëlqimi i prindërve) për të aktivizuar qasjen në materiale që mund të konsiderohen si të dëmshme për fëmijët.
- Shpifja dhe dëmtimi i reputacionit.
- Falsifikimi i moshës në rastet kur fëmijët pretendojnë të jenë më të vjetër, me qëllim që të kenë të drejtë qasjeje në faqet e internetit që janë të lejuara vetëm për të rritur, ngase kanë përmbajtje të papërshtatshme për fëmijë.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

SHENJAT PARALAJMËRUESE SE NJË FËMIJË MUND TË JETË NË RREZIK NGA PËRDORIMI I INTERNETIT



Fëmija shpenzon shumë kohë në internet, sidomos gjatë natës

Shumica e fëmijëve që bien viktima të keqbërësve, kalojnë shumë kohë online, sidomos natën, dhe veçanërisht në "chat". Keqbërësit zakonisht e shfrytëzojnë internetin gjatë natës për të gjetur dhe joshur ndonjë fëmijë.



Ju gjeni pornografi në kompjuterin e fëmijës suaj

Pornografia përdoret shpesh për t'i viktimizuar seksualisht fëmijët. Keqbërësit shpeshherë u dërgojnë fëmijëve material me përmbajtje pornografike, me qëllim që të hapin diskutime për tema me përmbajtje seksuale dhe t'i joshin ata.



Përdorimi i tepërt i telefonit

Fëmija juaj kalon shumë kohë në telefon duke komunikuar me një person që ju nuk e njihni, apo fëmija juaj flet me atë në telefon në orët e vona të natës. Keqbërësit nëpërmjet telefonit tentojnë të aranzhojnë takime të drejtpërdrejta me fëmijët tuaj.



Fëmija merr dhurata nga dikush që ju nuk e njihni

Gjatë shoqërimit me fëmijën tuaj, keqbërësi mund të dërgojë letra, fotografi dhe dhurata të cilat edhe mund të jenë mjaft të shtrenjta.



Fëmija e fsheh shpejt atë çfarë është duke bërë në internet

Fëmija juaj e ndërron shpejt ekranin e pajisjes me të cilën është i lidhur në internet, me qëllim që të fshehë diçka. Fëmijët nuk dëshirojnë që prindërit t'i shohin ata duke shikuar pornografi ose duke zhvilluar biseda me përmbajtje të papërshtatshme.



Ndryshimi i sjelljes - për shembull, fëmija bëhet i tërhequr nga familja

Keqbërësit të cilët dëshirojnë t'i shfrytëzojnë fëmijët, fillimisht tentojnë t'i bindin ata se prindërit jo çdo herë kanë të drejtë, në mënyrë që t'i dëmtojnë raportet e fëmijëve me prindërit apo me anëtarët tjerë të familjes. Çfarëdo problemi që fëmijët kanë në shtëpi, keqbërësi tenton të manipulojë me ta me qëllim që fëmijët të ndjehen të izoluar nga familja. Fëmijët nën ndikimin e keqbërësit mund të mbyllën në vetëvete, ngase mund të jenë të viktimizuar në forma të ndryshme.



Përdorimi i profileve të ndryshme online

Fëmijët përdorin llogari online e cila i përket dikujt tjetër. Edhe pse fëmija juaj tanimë ka një llogari të veten, keqbërësit mund ta krijojnë një llogari nëpërmjet së cilës fëmija juaj dhe keqbërësi mund të kenë më shumë privatësi kur komunikojnë. Në këtë mënyrë ata mund të aranzhojnë takime të drejtpërdrejta me njeri-tjetrin.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

ROLI I PRINDËRVE

Hulumtimet e ndryshme të bëra për sigurinë në internet kanë nxjerrë rezultate që tregojnë se në shumicën e rasteve prindërit nuk i dinë në detaje përvojat që përjetojnë fëmijët e tyre, si dhe nuk janë të vetëdijshëm për rreziqet që mund të shkaktohen gjatë përdorimit të internetit. Prindërit duhet të dinë se fëmijët e tyre mund të jenë duke përdorë online burime të ndryshme të internetit dhe përveç përdorimit të kompjuterit personal, fëmijët përdorin edhe pajisje tjera për t'u lidhur në internet, si: llaptop, tablet apo pajisje të ngjashme, si dhe telefona mobil.

Jopërvoja, naiviteti dhe sinqeriteti i tepruar i fëmijëve mund t'i çojnë ata drejt rreziqeve online. Për këtë, pavarësisht se fëmijët, krahasuar me prindërit, shpesh mund të jenë më të avansuar në teknologji dhe në përdorim të internetit, prindërit kanë përvojën jetësore dhe në çdo kohë duhet t'i këshillojnë ata dhe t'u ofrojnë atyre përkrahje në aktivitetet online.

Për të qenë të sigurt se fëmijët e përdorin internetin në mënyrë të duhur, prindërit

DUHET:

Të edukojnë fëmijët në lidhje me përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë, duke inkurajuar ata që të përdorin njohuritë dhe instinktin e tyre për të qenë të sigurt gjatë përdorimit të internetit.

Të qëndrojnë në gatishmëri për t'u përfshirë, angazhuar në aktivitetet online së bashku me fëmijët e tyre, pasi që angazhimi i prindërve ka një efekt të fuqishëm mbi përvojën e fëmijëve, duke promovuar sjelljet pozitive.

T'i lexojnë së bashku me fëmijët tyre kushtet e përdorimit të faqeve të internetit, para se ata të hyjnë në ato faqe. Të diskutojnë së bashku për masat e sigurisë, të vendosin disa rregulla themelore dhe të monitorojnë përdorimin e internetit për t'u siguruar se rregullat janë respektuar.

Të bisedojnë me fëmijët e tyre për aktivitetet e tyre në internet dhe me kë ata komunikojnë. Fillimi dhe mbajtja e këtij dialogu është vendimtare për të ndihmuar dhe për të mbajtur fëmijët të sigurt gjatë përdorimit të internetit.

Të kontrollojnë për të parë nëse faqja e internetit ofron mundësi teknike të tilla, si:

- *filtrimi dhe kontrolli prindëror;*
- *ruajtja e historisë së përdorimit të faqeve nga fëmijët e tyre;*
- *moderimi i përdorimit të faqeve nga ndonjë personi, që shërben për bllokimin e materialeve ofenduese, duke reaguar ndaj sjelljeve të dyshimta dhe duke paralajmëruar përdoruesit;*
- *postimi i fotografive dhe videove;*
- *Raportimi dhe bllokimi i shërbimeve dhe materialeve të papërshtatshme për fëmijë;*
- *verifikimi i moshës.*

Të qëndrojnë të qetë dhe të mos reagojnë menjëherë në qoftë se kuptojnë se fëmijët e tyre, ose të ndonjërit prej miqve të tyre, kanë bërë ndonjë sjellje jo të mirë online. Disa faqe në internet janë shumë të rëndësishme për jetën sociale të fëmijëve. Nëse fëmijët kanë frikë se do t'u ndërpritet qasja në këto faqe, ata ka gjasa që të fillojnë ta paraqesin këtë problem në mënyrë publike në internet nëpërmjet postimeve të ndryshme.

T'i këshillojnë fëmijët që mos t'ua tregojnë fjalëkalimet e tyre miqve, anëtarëve tjerë të familjes apo të panjohurve.

T'i mësojnë fëmijët për kulturën e komunikimit në internet, për rreziqet e mundshme dhe për përdorimin e sigurt të internetit.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

SI T'U OFRONI FËMIJËVE TUAJ PËRDORIM TË SIGURT TË INTERNETIT

Kjo pjesë e Udhëzuesit ka për qëllim t'u ofrojë prindërve këshilla se si ata duhet t'i mësojnë fëmijët e tyre për t'u mbrojtur gjatë përdorimit të internetit.

Prindërit duhet:

- të marrin parasysh se ekzistojnë faqe të internetit me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët;
- të kuptojnë aftësitë dhe njohuritë e fëmijëve të tyre për përdorim të internetit;
- të kuptojnë se sa janë gjasat që ata mund të zvogëlojnë rreziqet, para se të vendosin se cili vend (ambient) dhe cila pajisje është e përshtatshme për përdorimin e internetit nga fëmijët e tyre.



Interneti ka potencial të madh si një mjet për zhvillimin dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe për t'i ndihmuar ata në hulumtimin e gjërave për nevojat e tyre.

Të mësuarit e mënyrave të sjelljeve pozitive dhe të përgjegjshme gjatë përdorimit të internetit duhet të jetë një ndër objektivat kryesorë për prindërit.

Më poshtë janë paraqitur disa këshilla dhe udhëzime në lidhje me masat që duhet të ndërmerren prindërit dhe kujdesin që ata duhet të tregojnë për të mbrojtur fëmijët e tyre gjatë përdorimit të internetit:

1. Filloni të bisedoni sa më herët me fëmijët tuaj

Prindi bashkëpunues



- Përdorni kontaktet e përditshme me fëmijët për të biseduar lidhur me përdorimin e internetit. Mos prisni që ata të fillojnë bisedën, edhe nëse ju jeni shumë të afërt në komunikim me ta.
- Sapo fëmija fillon të përdorë kompjuterin, telefonin celular ose ndonjë pajisje tjetër për t'u kyçur në internet, prindërit duhet të bisedojnë me të dhe t'i tregojnë se si duhet të sillet dhe si duhet të komunikojë me të tjerët .
- Duhet të bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me sigurinë në internet, para se këtë ta bëjë dikush tjetër.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

2. Mbani pajisjet e lidhura me internet larg hapësirave të shtëpisë të cilat vështirë monitorohen



- Mbani pajisjet e lidhura me internet në një zonë të hapur, në mënyrë që përdorimi i internetit në shtëpitë jetë sa më transparent. Sidoqoftë, në familjet ku përdoren më shumë se një pajisje që kanë mundësi lidhjeje në internet, duhet pasur kujdes, sepse këmbëngulja e prindërve se të gjithë duhet të përdorin internetin

në të njëjtën dhomë dhe në të njëjtën kohë mund të shkaktojë pakënaqësi.

- Mundohuni të jeni sa më shumë të pranishëm në momentet kur fëmijët janë duke përdorë internetin, si dhe konsideroni përdorimin e programeve për monitorim siç është “parental control”.
- Kujdes, sa më shumë që rriten fëmijët, ata kërkojnë më shumë privatësi gjatë përdorimit të internetit. Këtë e arrijnë shpesh duke përdorë telefona mobil, laptop, apo pajisje tjera teknologjike dhe rrjetin wireless. Në këtë rast është mjaft e vështirë t'i monitoroni fëmijët gjatë përdorimit të internetit.

3. Instaloni dhe azhurnoni antivirusin dhe programet mbrojtëse

- Sigurohuni se kompjuteri juaj ka të instaluar program mbrojtës (firewall) dhe antivirus, dhe se ky program është funksional dhe i azhurnuar.
- Mësoni fëmijët se si t'i përdorin dhe si t'i azhurnojnë këto programe.
- Kujdes! Programet mbrojtëse dhe antiviruset nuk janë gjithmonë efektivë dhe e vetmja mënyrë e mbrojtjes.

4. Krijoni një ambient të hapur dhe të përshtatshëm për bisedë me fëmijët

- Fëmijët çdo herë presin ndihmë nga prindërit e tyre. Prandaj, bëhuni mbështetës dhe pozitiv në këtë drejtim. Dëgjoni me vëmendje dhe durim kur ata flasin dhe keni parasysh ndjenjat e tyre.
- Bëhuni të durueshëm. Shumica e fëmijëve kanë nevojë t'i dëgjojnë informatat apo këshillat tuaja disa herë.
- Komunikimi i hapur me fëmijët tuaj është mjaft i rëndësishëm, prandaj angazhohuni sa më shumë për ta mbajtur atë. Mos reagoni vrazhdë kur fëmijët tuaj ndajnë përvojën e tyre me ju, sidomos nëse kuptoni se fëmija juaj ka bërë diçka të papërshtatshme gjatë përdorimit të internetit.
- Rregullisht bisedoni me fëmijët tuaj se si dhe për çfarë ata e përdorin internetin dhe me kë komunikojnë në internet. Inkurajoni fëmijët tuaj që t'ju tregojnë nëse diçka që hasin në internet, i bën ata të ndjehen të kërcënuar ose të shqetësuar.
- Mësoni fëmijët tuaj se njerëzit gjatë komunikimit në internet, shpesh nuk janë në të vërtetë ata të cilët thonë se janë. Keqbërësit shpesh përdorin komunikimin "chat" për të kontaktuar fëmijët dhe në shumë raste ata fshehen pas pseudonimeve të ndryshme.
- Falenderoni fëmijët tuaj për besimin që kanë ndaj jush dhe bindni ata se duhet të raportojnë abuzuesit.

UDHËTIMI nëpër INTERNET

5. Krijoni rregullat e përdorimit të internetit dhe të telefonit mobil



- Komunikoni, krijoni dhe pajtohuni për një listë të rregullave për përdorim të internetit dhe telefonit. Kjo listë duhet të përmbajë rregullat se si dhe kur fëmijët mund ta përdorin internetin dhe telefonin. Disa nga rregullat mund të jenë si në vijim:
 - nëse fëmijët tuaj duhet apo nuk duhet të qasen në internet;
 - sa shpesh mund ta përdorin atë;
 - çfarë materialesh mund të shkarkojnë;
 - si të sillen kur hasin në gjëra të papërshtatshme;
 - sa kohë mund të shpenzojnë në telefon;
 - kohën kur mund të përdorin internetin në telefon (p.sh. jo natën vonë).
- Gjatë krijimit të listës së rregullave, vëmendje të veçantë duhet kushtuar privatësisë, moshës dhe faqeve të internetit me përmbajtje të papërshtatshme për fëmijët.

6. Familjarizohuni me faqet e internetit të përdorura nga fëmijët tuaj




- Vlerësoni faqet e internetit të cilat fëmijët tuaj i vizitojnë dhe lexoni me kujdes: rregullat e privatësisë, kushtet e përdorimit dhe kodet e sjelljes. Gjithashtu, hulumtoni nëse faqja e internetit monitoron përmbajtjen e postuar.
- Familjarizohuni me atë se çfarë bëjnë fëmijët tuaj në internet dhe kontrolloni periodikisht faqet që i vizitojnë fëmijët tuaj.
- Kuptoni se si fëmijët i përdorin pajisjet personale (telefonat mobil,

video lojërat, dhe pajisjet tjera) për t'u lidhur në internet. Çështja e sigurisë së përdorimit të këtyre pajisjeve duhet të trajtohet ngjashëm sikur lidhja përmes kompjuterit të zakonshëm.

- Prindërit duhet të dinë se si dhe për çfarë shërbejnë këto pajisje personale.

7. Rishikimi i karakteristikave të faqeve të internetit



- Sigurohuni nëse filtrimi, bllokimi dhe programet monitoruese janë të mjaftueshme për përdorim të sigurt të internetit.
- Rekomandohet që prindërit të diskutojnë me fëmijët lidhur me arsyet dhe nevojën e përdorimit të programeve monitoruese dhe mbajtjes fshehtë të fjalëkalimit të këtij programi.
- Mbani kartelat bankare të sigurta dhe mos zbuloni fjalëkalimin (PIN) e këtyre kartelave. Keni parasysh se kur fëmijët fillojnë të blejnë në internet, gjasat rriten që ata të përdorin këto kartela edhe pa pëlqimin tuaj.
- Sigurohuni se bëhet verifikimi i moshës kur blihet ndonjë artikull apo kur ofrohen shërbime nëpërmjet internetit. Bllokoni qasjen në faqet e internetit me përmbajtje dhe shërbime të papërshtatshme për fëmijët.
- Kontrolloni nëse keni mundësi të fshini apo ndryshoni llogarinë tuaj në faqet e internetit. Nëse kjo gjë nuk është e mundur, atëherë kërkoni nga fëmijët tuaj që të mos e përdorin atë faqe, ose bllokoje qasjen në atë faqe.
- Monitoroni reklamat të cilat janë të papërshtatshme për fëmijët, sepse ato mund të nxisin ata që të kontaktojnë me njerëz të panjohur, të qasen në fajlla të rrezikshëm, të bëjnë sajberdhunë, apo ndonjë fenomen tjetër të ngjashëm.

8. Edukimi i fëmijëve

- Shpjegojuni fëmijëve tuaj disa nga rregullat dhe udhëzimet më elementare lidhur me përdorimin e internetit. Është me rëndësi që fëmijët t'u përmbahen këtyre udhëzimeve dhe t'i ndajnë ato edhe me të tjerët.
- Edukoni fëmijët tuaj që të mos përgjigjen në mesazhe të vrazhda dhe t'u shmangen bisedave online rreth çështjeve seksuale.
- Mësoni fëmijët tuaj që të mos hapin “attachment” ose linqe të faqeve të internetit që mund të shfaqen gjatë bisedave në chat, apo kur pranojnë ndonjë e-mail prej personave të panjohur.
- Shpjegojuni fëmijëve tuaj që asnjëherë të mos takohen me persona të panjohur, të cilët i kanë njohur vetëm në internet.
- Inkurajoni fëmijët që të përdorin faqet e internetit vetëm për të komunikuar me miqtë e tyre dhe jo me njerëz të panjohur.



UDHËTIMI nëpër INTERNET

- Tregojuni fëmijëve se njerëzit online mund të mos jenë ata që thonë se janë.
- Nëse fëmija dëshiron patjetër që të takojë personin që e ka njohur vetëm në internet, atëherë prindi apo ndonjë i afërm i tij i moshës së rritur duhet ta shoqërojë fëmijën në atë takim. Sigurohuni që takimi i parë të bëhet në një vend publik, ku ka edhe shumë njerëz të tjerë.
- Vetëdijësoni fëmijët tuaj që të mos i shpërndajnë të dhënat e tyre identifikuese personale. Ata duhet të kuptojnë se cilat informata duhet të mbahen private dhe mos të publikohen në profil të hapur.
- Inkurajoni fëmijët tuaj që të mos postojnë informata personale të tyre apo të miqve të tyre (si psh. fotografitë, numrin e telefonit mobil, adresat e vendbanimeve, apo emrin e shkollës së tyre) në internet.
- Shpjegojuni fëmijëve se ata duhet të postojnë vetëm informacione që ju si prind dhe të tjerët të ndiheni rehat kur i shihni ato informacione. Fëmijët duhet të kuptojnë se informacionet e postuara në internet nuk mund të kthehen prapa.
- Shpjegojuni atyre se fotografi të dhe videot zbulojnë shumë informata personale. Prandaj, sigurohuni se fëmijët tuaj e kanë kuptuar se çfarë do të thotë të postojnë fotografi dhe video në internet.
- Udhëzoni fëmijët tuaj që asnjëherë të mos përdorin web-kamerat në komunikim me persona të panjohur.
- Këshilloni ata që të mos postojnë në internet materiale pa miratimin tuaj.
- Shpjegojuni fëmijëve se ajo çfarë ata shkruajnë në internet mund të lexohet nga kushdo tjetër.
- Informoni fëmijët se keqpërdoruesit apo ngacmuesit shpesh kërkojnë fëmijë, të cilët janë të interesuar për të njohur miq të rinj në internet.

9. Shqyrtimi i përdorimit të sigurt të faqeve të internetit (mos duhet te vendoset)

- Kontrolloni rregullisht profilin e fëmijës suaj.
- Shikoni historinë e llogarisë së tij dhe, nëse është e nevojshme, ndrysho mënyrën e përdorimit të profilit të tij në një nivel që ju të ndjeheni rehat.
- Faqet e internetit që janë të dizajnuara mire, prindërve i ofrojnë mundësi që ata vetë të vendosin “parental control”.
- Ju mund të kontaktoni administratorët e faqes për të kërkuar që të fshihet profili i fëmijës suaj, nëse ai refuzon të respektojë rregullat e asaj faqeje. Ky fakt gjithashtu duhet të forcojë mesazhin tuaj tek fëmijët në lidhje me rëndësinë e rregullave si dhe për pasojat e mosrespektimit të këtyre rregullave.
- Sigurohuni se fëmija juaj respekton kufizimet e moshës në faqe të caktuara të internetit. Nëse fëmijët janë më të rinj se sa moshja e rekomanduar për përdorimin e këtyre faqeve, ata nuk duhet t'i përdorin këto faqe. Për shembull, moshja minimale e lejuar për të hapur profil në rrjetet sociale siç janë Facebook apo Twitter, është moshja 13 vjeçare.
- Sigurohuni se fëmijët nuk përdorin emrin e plotë të tyre gjatë komunikimit në internet. Kudo që të jetë e mundur ata duhet të përdorin pseudonime.
- Mos lejoni fëmijët tuaj të postojnë emrat e plotë të miqve të tyre apo çfarëdo të dhëne tjetër që mund të përdoret për të identifikuar ata, siç janë: adresa, numri i telefonit, emri i shkollës dhe informatat tjera personale identifikuese.

UDHËTIMI NËPËR INTERNET

KONKLUSIONE

Interneti ka transformuar jetën moderne, duke ofruar komunikim të shpejtë dhe qasje të pakufizuar në informata dhe shërbime. Mirëpo, interneti ka krijuar gjithashtu edhe mundësi të reja për keqpërdoruesit dhe abuzuesit e fëmijëve. Prandaj, pa përdorimin e masave të duhura mbrojtëse, fëmijët mbeten të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme në internet, siç janë: sajberdhuna, pornografia, apo qasja në materiale të tjera të dëmshme.

Është shumë me rëndësi që prindërit, së bashku me fëmijët, të vendosin rregulla se çka është e përshtatshme dhe e sigurt për t'u përdorë në internet dhe se si fëmijët e tyre të sillen në mënyrë të përgjegjshme. Duke punuar së bashku prindërit dhe fëmijët, mund të përfitojnë më shumë nga përdorimi i internetit dhe në të njëjtën kohë të minimizojnë rrezikun që mund t'u kanoset fëmijëve nga përdorimi i pasigurt i internetit.

Gjithashtu, është mjaft e rëndësishme për gjeneratat e ardhshme që të ndihen të sigurt në përdorimin e internetit, me qëllim që ata pastaj të përfitojnë nga zhvillimi dhe përparimi i tij. Kur flitet për sigurinë e fëmijëve në internet, është me rëndësi jetike të flitet hapur për rrezikun në lidhje me përdorimin e pasigurt të internetit.

Në këtë mënyrë prindërit do të mësojnë se si t'i evitojnë apo si të ballafaqohen me rreziqet që mund t'u kanosen fëmijëve të tyre.

Shpresojmë se ky Udhëzues do t'u ndihmojë prindërve dhe fëmijëve, duke ju ofruar informata të qarta dhe gjithëpërfshirëse për sigurinë në internet, me qëllim të zvogëlimit të rreziqeve dhe rritjes së mundësitë për të përfituar sa më shumë nga përdorimi i internetit.

Poashtu informata më të hollësishme për përdorim sa më të sigurt të internetit mund të gjeni edhe në gjuhën shqipe në webfaqen www.internetisigurte.org.

Katalogimi në botim - (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

004:37(075.2) (035)

Zymeri, Teuta
Udhëtimi nëpër internet : udhëzues për prindër. - Prishtinë :
MASHT, 2017. - 32 : ilustr. me ngjyra; 21 cm.

ISBN-978-9951-16-110-7

UDHËTIMI nëpër INTERNET



Udhëzues për prindër



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstva za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju
Ministry of Education, Science and Technology*

Të gjitha të drejtat për ribotim i përkasin MASHT



9 789951 161107